



Vllaznia B nuk ia del të marrë fitoren e katërt rradhazi në kampionat. Ajo është mundur 0-1 në "Reshit Rusi" nga Egnatia. Pjesa e dytë nis me një zëvendësim për shkodranët. Erkoçeviq i le vendin Kapaklijës në mesfushë. Loja do të jetë e barabartë për të dy ekipet që nuk rrezikojnë shumë, ndoshta duke ruajtur njëra-tjetrës. Egnatia e qarkullon me mirë topin megjithatë nuk arrin të krijojë raste nderkohe që Vllaznia B në dy momente me Hajdarin rrezikon seriozisht. Por në minutën e 76-të një nga lojtarët afrikane të Egnatia kujtohet në pozicion jashtë lojë nga mbrojtësit shkodrane por arbitrat vazhdojnë lojën dhe ai arrin ta dërgojë topin në rrjetë. Kuqëblutë hidhen në sulm për të barazuar megjithatë nuk ia dalin duke pranuar humbjen.

© **vllaznia.al**